



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 03

Datë: 20. 02. 2017. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Binak Vishaj, Bajram Ljatifi, Nenad Rikallo, Ercan Spat dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

Përkthyes: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.01 dhe 02/2017;*

2. Aktivitetet e ZRPP-së;

- *Shqyrimi dhe miratimi i Rekomandimit lidhur me ecurinë e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Partisë Politike, „Partia e Drejtësisë“ PD dhe emërimet e anëtarëve në organet drejtuese nga Kryetari;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për shfuqizimin e pezullimit për katër (4) parti politike;*
- *Shqyrimi dhe miratimi i Rekomandimit për shqiptimin e gjobave për tri (3) parti politike;*

3. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- **Këshilli për Çështje Ligjore;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendeve Komunale në Komunat: Istog, Obiliq dhe Ferizaj;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Agjendës për takimin e punës KQZ –SKQZ;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft vendimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc, të mbajtura me datën 04 dhjetor 2016, si dhe Rundin e Dytë të Zgjedhjeve të mbajtura më 18 dhjetor 2016;*
- **Këshilli i Personelit;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së drejtorit të prokurimit, për angazhim të stafit shtesë, për shkak të aktiviteteve të shumta në punë;*
 - *Shqyrtimi i dhe miratimi i kërkesës së Koordinimit në Teren;*
 - *Informatë për rekrutim të pozitës së ZLKZ-së në Drenas;*
- **Këshilli për Buxhet dhe Financa;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Gllogoc;*
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për takimin e punës KQZ –SKQZ;*
- **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Strategjisë të Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale 2017;*

4. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.01 dhe 02/2017

Valdete Daka: Mirëse keni ardhë, e kemi një rend dite të jashtëzakonshëm...! A ka ndonjë propozim për ndryshim, apo...?

Adnan Rrustemi: Jo veç, për pikën e Këshillit të Personelit që janë në fakt tri pika, dhe nën-pika, nuk kemi marrë material...unë kam hulumtuar, dhe, edhe këtu nuk po shoh që ka material...!

Enis Halimi: Nuk e di, por ka mundësi që të ketë probleme me materialet...

Valdete Daka: Sa po shoh unë, nën-pika tre, është informatë.

Bajram Ljatifi: Është marrë vendim që materiali të debatohet në vork shop, ndoshta unë jam gabim...!

Nenad Rikalo: Në këshill, një pjesë të materialit e kemi pas, tash nuk është këtu...!

Ilir Gashi: Kërkesa e parë, është kërkesë e trajtuar në këshill. E para, është kërkuar staf shtesë për shkak të aktiviteteve që priten, kurse e dyta, është kërkesë e koordinatorit të terrenit: një kërkesë që është trajtuar në këshill dhe, s'ka të bëjë fare me mbledhjen e KQZ-së. Kjo, është pjesë e planit të shqyrtimit të rregullimit të brendshëm, dhe hiqet prej rendit të ditës. Dhe e treta, është informatë që ka qenë në këshill lidhur me pozitën e KKZ-së në Drenas...

Adnan Rrustemi: S'kemi ekskluzivitet për punën e ndonjë këshilli, cili do që e drejtomë...dhe kjo vlen për të gjithë këshillat...E dyta, pavarësisht relevancës, propozoj që në mungesë të materialit me u heq prej rendit të ditës, dhe e treta, ka qenë një diskutimi i vazhdueshëm në KQZ dhe, se kam menduar që është etabluar si standard: që, edhe informatë të mos kemi pa shkrim, sepse kemi diskutuar gjerë e gjatë për këtë punë, pra të na dërgohet pavarësisht cilësisë së informatës...

Betim Gjoshi: E para, pika një, te këshilli i personelit duhet vendimmarrje: e thotë rregullorja e punës, jo unë..., rendin e ditës e kam analizuar në bazë të rregullores së punës...! Nëse nuk ka material...?

Lidhur me strukturën e agjendës së mbledhjes, me pikat e kësaj mbledhjeje, me heqjen, ndryshimin, plotësimin e agjendës, më tutje diskutuan edhe: Eshref Vishi, Binak Vishaj, Ilir Gashi, Valdete Daka, Bajram Ljatifi dhe Sami Hamiti.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 1 dhe 2 /2017

Anëtarët e KQZ-së, me vërejtjen e Eshref Vishit, Betim Gjoshit dhe Bajram Ljatifit, miratuan këto procesverbale.

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrimi dhe miratimi i Rekomandimit lidhur me ecurinë e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të Partisë Politike,, Partia e Drejtësisë“PD dhe emërimet e anëtarëve në organet drejtuese nga Kryetari

Ercan Spat: Më duket se nuk kemi material për këtë pikë të gjithë anëtarët...!

Miradije Mavriqi: Zyrtari ynë, e ka përcjellë Kuvendin e Jashtëzakonshëm që është mbajtur në shtator 2016, po ashtu edhe materialet e tjera dhe, kemi përgatitur raportin me vërejtjet e caktuara që, i kemi evidencuar: problemet me respektimin e statutit, dhe të gjeturat e tjera etj.

Betim Gjoshi: Ju falënderoj që më në fund, e kemi materialin..., sepse nuk kemi qenë korrekt me këtë parti...Mirë do ishte me na shpjeguar se, pse jemi vonuar deri më sot sepse, kemi kaluar standardet dhe procedurat, analogjitë e mëhershme...Konstatimet dhe të gjeturat janë ok..., por te pjesa e konstatimeve që duhet të quhen "rekomandime", ka një diskrepancë: E para, njëherë e kemi diskutuar në këshill dhe e kemi miratuar, neve na është drejtuar disa herë shkresa sa i përket kuvendit të jashtëzakonshëm, veç njoftimit që është dërguar më 26 dhjetor 2016, na ka ardhur një shkresë që i drejtohet Partisë së Drejtësisë me 7.11.2016, ku e kemi diskutuar dhe miratuar në Këshill për Çështje Ligjore, dhe versioni u është dërguar anëtarëve të KQZ-së më datën 8...Pastaj na ka ardhur me 16.11. 2016 një rekomandim tjetër, dhe me 1.12.2016 prapë një rekomandim tjetër, dhe me 6.12.2016 po ashtu, një rekomandim tjetër...Këtë të fundit, e kemi sot në rend dite. Që të jemi i qartë, po e lexojë (z. Gjoshi, lexoi rekomandimin e parë, dhe këtë të fundit...), por ne nuk mundë ta zgjedhim kontestin sepse, ata e kanë statusin bazë për zgjidhje, por nëse nuk mund t'i zgjedhin problemet, shkojnë në gjykatë...

Për mua, rekomandimi korrekt është se, KQZ nuk i njuh të dy vendimet e palëve nga kuvendet, dhe i rekomandon partisë që në pajtim me statutin e vetë të bëjë zgjedhjen e duhur...kanë komision statutar, dhe nëse nuk mund t'i zgjidhin problemet të shkojnë dhe ta gjejnë zgjidhjen në gjykatë...Unë, me këtë rekomandim që kemi sot para vetes, do të votoj kundër...

Adnan Rrustemi: Është e vërtetë se ka zgjatur shumë kjo çështja e partisë së drejtësisë, dhe ka pas zhvillime dhe aktivitete në të dy anët...Jam munduar me e zbërthe këtë dosjen e kësaj partie, dhe e kam edhe unë një mendim lidhur me këtë parti: E para pajtohem me gjetjet, dhe me referimi që është bërë me dispozitat ne statut te PD-se. Ata, kane tre mënyra se si thirren kuvendet e jashtëzakonshme. Disa aktivitete, disa janë trajtuar gabimisht, disa nuk janë trajtuar si duhet...! Nëse ne jemi një instance qe bëjmë një vendimmarrje, dhe jo vetëm sugjerime dhe rekomandime për çështje te këtilla, unë mendoj qe nga ky aspekt, i mungojnë konstatimet përfundimtare: se, nuk e përmbyllin çështjen, dhe nuk e përmbyllin çështjet. Mirëpo, mendoj qe raporti përfundimtar, ka një përpjekje për zgjidhje, por nuk është arritur të konstatohet zgjidhja. Ashtu siç unë mendoj, kërkesa e shumicës së degëve për me mbajt kuvend të jashtëzakonshëm, kryesia e PD-se është dashur ti përgjigjet, dhe kjo është edhe me statut. Kryesia, është dashur ta shqyrtoj kërkesën...Pra, nëse ne nuk e njohim kuvendin e jashtëzakonshëm, as ndryshimet në bord, në kryesi, pyetje është se çka njohim ne në PD...?

Unë mendoj, tha z. Rrustemi, që ZRPP duhet t'i bëjë kërkesë kryesisë së PD-së që në përputhje me statutin ta shqyrtoj kërkesën e shumicës së degëve për kuvend të jashtëzakonshëm. Le ta thirr kryesia, dhe le të vendosin...

Bajram Ljatifi: Aq shumë bërë gabime në kryesi dhe në kuvende jashtëzakonshme sa që ne, nuk duhet shumë që të diskutojmë, por vetëm duhet të shohim se çfarë konstatimesh do të formulojë KQZ në lidhje me këtë parti. KQZ, nuk mundet të vendos që të mbahet kuvendi i jashtëzakonshëm, sepse KQZ u përgjigjet vetëm kuvendeve të rregullta. Por, ata kërkojnë nga ne që të monitorojmë një kuvend të jashtëzakonshëm të tyre, ne, vetëm duhet që ti konstatojmë ndryshimet, por ne nuk mund të ndërhyjmë, nuk kemi të drejtë...Neve na interesojnë vetëm kuvendet e zakonshme...të rregullta.

Betim Gjoshi: Praktikë është që, ne vetëm monitorojmë kuvendet, i azhurnojmë ndryshimet e partive politike, por në të dy rastet nuk i kanë azhurnuar ndryshimet në bazë të rregullores së punës...Ne, nuk mund të ndërhyjmë deri atje sa, të ndërhyjmë si te një kompani private...Ata, nuk e kanë zgjedhur rrugën e degëve me thirr kuvendin, por kanë shkuar në Këshill Drejtues me thirr kuvendin pa i respektuar procedurat...

Kend e njohim ne, minimalisht është e ditur: njihen ata që janë zgjedhur në procedurë të rregullt. Ndryshimet, ndodhin në pajtim me procedurat...Legjitim janë ata që janë zgjedhur në kuvendin e rregullt 2015...

Sami Hamiti: Është e vërtetë që është zgjatur çështje, dhe nganjëherë nuk është fajtoreshefja e zyrës sepse, kemi pasur konsultime më të gjata rreth kësaj pune...Realisht, e kam analizue edhe unë: statutin...formatin që ka, por ai është që është...Problemet e shkeljeve, është e vërtetë që i kanë bërë te dy palët, por duhet me i analizuar në bazë të shifrave: 112 nga 168 janë më shumë se 2/3 e një kuvendi...! A është dashur me i pru azhurnimet e 2016-tes...? Kend përfaqëson ai me 50 vetë...? Ai kryetar që është zgjedhur nëse i ka më shumë se 2/3 kundër, është një absurditet...

Janë edhe konstatimet në proceverbal...! Pastaj, kujt duhet pranuar azhurnimet...? Pra, është non sens...Faktet flasin ndryshe...Zyra, duhet të japë një sugjerim, një përgjigje...! Por, me 1/3 e anëtarëve të kuvendit, si me u njoftë...?

Valdete Daka: Kish me qenë që ne me filluar prej kuvendit të fundit të rregullt 2015: cilat organe kanë dal, kush ka qenë kryetar...Dhe, kemi një kuvend jo të rregullt...! Pra, kemi një kuvend që ka qenë jo i rregullt, nuk mundet me prodhuar vendime të rregullta...Unë po flas si juriste se, a është thirr kuvendi i jashtëzakonshëm në mënyrë të rregullt...? Konstatimi i anëtarëve të KQZ-së është se, ky kuvend nuk është thirr në mënyrë të rregullt, nëse kthehemi në kronologji të zhvillimeve që kanë ndodhur. Po e krahasoj: sikur një kontratë që lidhet në mënyrë jo të rregullt, ajo është nule, nuk prodhon efekte juridike. Të gjitha vendimet e një kuvendi, ftesa, vendimet e marra nuk prodhojnë vendime juridike ndaj askujt...Unë për vete, nuk mendoj se duhet dërguar rekomandime: me mbajt, ose mos e mbani kuvendin...Ne, vetëm duhet të marrim një konstatim se, Kuvendi i fundit i rregullt është ai i fundit, kurse kuvendi i jashtëzakonshëm i mbajtur, të gjitha vendimet e më pastajmë të të gjithëve, për mua janë nule...Ne, as nuk mund ti shqyrtojmë si KQZ vendimet e marra...sepse, për ne është valid vetëm kuvendi i fundit...Ky, është mendimi im personal, po flas si juriste...

Eshref Vishi: Po ndërlidhem me atë se, ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga kërkesa apo nga procedimi që kanë bërë në KQZ. Ky subjekt, është në pritje të një përgjigjeje nga ne...

Nga ai moment, gjendja në këtë subjekt u tha se ka ndryshuar...Janë krijuar paralelizma, organe paralele, dualizma...emertime të reja, bartës të organeve të reja...Unë, jam për atë që situatën të mos e acarojmë më tepër, dhe mos të rrisim pakënaqësi me ndonjë vendim...

Valdete Daka ; Kishte qene mire me filluar, prej Kuvendit të fundit të rregullt, edhe kush ka qene kryetar legjitim, edhe cilat kanë qenë organet e rregullta që kanë dalë nga ai kuvend i rregullt. Tash e kemi kuvendin tjetër të jashtëzakonshëm, a është thirr ai në mënyrë të rregullt apo jo. Po më duket se konstatimi i të gjithëve është se qaj kuvend, nuk

është thirr në mënyrë të rregullt nëse kthehemi në retrospektiv. Po nisem si juriste, ai kuvend që është thirr në mënyrë jo të rregullt, nuk mundet me prodhuar efekte...Si një kontratë që lidhet, edhe është jo e rregullt – nule, ajo nuk ka efekt juridik. Të gjitha vendimet e një kuvendi i cili ka qenë i ftuem, baza ka qenë jo e rregullt, ftesa, të gjitha vendimet që janë marrë në atë kuvend nuk munden me prodhuar kurrfarë efekte juridike ndaj askujt.

Ne, vetëm mundemi me e dërgue një konstatim se kuvendi i fundit që është mbajtur i rregullt, i fundit...kur a mbajtur, është legjitim, kurse kuvendi që është mbajtur pas këtij, jo i rregullt, kur a mbajtur, është jo i rregullt, dhe si i këtillë, të gjitha vendimet që janë marrë, qofshin të atij kryetari, qofshin të këtij këshilli, organet e tyre udhëheqëse janë nule...

Ky, është mendimi im personal...

Eshref Vishi - Ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, nga procedimi i shkresave. Subjekti, është duke pritur një përgjigje nga ne...Janë krijuar paralelizma, gjendja ka degjeneruar, kemi organe të reja, bartës të funksioneve të reja...Vendimi ynë, është mjaft domethënës, dhe ne mos ta acarojmë situatën...

Valdete Daka: A është monitoruar ky kuvend...?

Miradije Mavriqi: Po...

Adnan Rrustemi: Monitorimi, nënkupton njëfarë legjitimiteti...Cili është roli i KQZ-së këtu...? Unë mendoj që minimalisht, duhet orientuar statutit të tyre. Unë, nuk hyra në analizë të numrave, në aspektin përmbajtësorë se, me ju referuar numrave, gjendja është dukshëm ndryshe për grupin që e konteston.... Grupi që e ka mbajtur kuvendin e jashtëzakonshëm, e ka mbajtur në kundërshtim me statutin sepse, ka vendosur në mënyrë të thjeshtë, e është dashur të vendos me 2/3. Por, kërkesa e shumicës së degëve për me thirrë kuvend të jashtëzakonshëm, është legjitime dhe në përputhje me statutin dhe kësaj kërkesë, dikush duhet t'u përgjigjet.

Betim Gjoshi: Ne shkojmë me ftesë, dhe pastaj zyra jep vlerësim, bën rekomandim...Nuk ka lidhje pse e kanë monitoruar këtë kuvend. Ne kemi një rrugë ligjore: e para, është një kuvend që është mbajtur dhe është nul, dhe është një grup që i ka ndërruar të tjerët, dhe e ka plotësuar numrin, por edhe ky është nul në bazë të gjetjeve të zyrës. Ne, këto duhet t'i trajtojmë: nuk i merr për bazë azhurnimet, nuk i merr për bazë ndërrimet, dhe udhëzohen që të bëjnë zgjidhje në bazë të statutit...Ne, më tutje nuk mund të shkojmë sepse, ndryshe ndërhyjmë në punë të tyre...Nuk e kemi rastin e parë, kemi pasur edhe parti të tjera...

Ercan Spat: Kam pyetje konkrete për zyrën: Ne, ne në një mbledhje paraprake për suspendimin e 8 partive politike. Kjo parti, nuk është në listë. Me cilën udhëheqësi, janë dorëzuar azhurnimet...?

Betim Gjoshi: Afati i dorëzimit...ata, kanë mundur të dorëzojnë çka të duan, por ne, në bazë të këtij vendimi ne kemi me i pranuar azhurnimet! Afati ka qenë, por ende s'kan arritur me i analizuar materialet se a janë dërguar në pajtim me statutin. Ndoshta dy grupacionet kanë dorëzuar azhurnime...

Binak Vishaj: anëtarët thanë që jemi vonuar...Nuk jemi vonuar as ne, as zyra sepse kemi pasur zgjedhje dhe, s'kemi pas as kohë. Ne, mendoj që duhet të jemi në funksion të gjetjes së zgjidhjes, e kanë provuar por nuk kanë mundur të gjejnë zgjidhje. Sipas meje, KQZ duhet të ndërtoj raport me kuvendin e fundit legjitim. Ata, duhet të dorëzojnë raportin, listat për zgjedhje dhe në bazë të tyre, ne duhet të kemi një qartësi më të madhe...

Valdete Daka: Për mua, kuvendi i thirrur në mënyrë të ligjshme, ai është legjitim. Por, kuvendi i jashtëzakonshëm, nuk është funksional. Azhurnimet e kuvendit të jashtëzakonshëm, nuk janë të pranueshme. Ne, duhet të dërgojmë konstatim me këtë përmbajtje...

Bajram Ljatifi: Vendimet që janë marrë në kuvendin e jashtëzakonshëm nuk prodhojnë efekt dhe, nuk ZRPP nuk mund t'i regjistroj ndryshimet...Kjo, është një çështje e përfunduar. Për KQZ -në, valid është kuvendi i rregullt..

Betim Gjoshi: Ne kemi edhe vendime të një kuvendi tjetër, prandaj të gjitha duhet t'i konsiderojmë nule...

Valdete Daka: Pas mbajtjes së kuvendit të rregullt, cilido grup që ka mbajtur kuvend, vendimet e tyre janë jo valide, janë nule...Të gjitha vendimet që kanë dalë nga kuvendet e grupeve, janë nule...Kuvendet janë ftuar në kundërshtim me statutet...dhe vendimet që kanë dalë, nga kuvendet e të dy grupet...janë nule, sepse janë në kundërshtim me statutin...

Sami Hamiti: Kënd e njeh...? Më shumë se 2/3 e kuvendit, janë kundër kryetarit...Por, jo me e njoftë kryetarin...!

Adnan Rrustemi: Çështja është komplekse, unë nuk po e kuptoj zgjidhjen...! Kërkesa e degëve për me thirr kuvend, është e drejtë...Dhe kjo, s'po merr përgjigje...

Betim Gjoshi: Zgjidhja, duhet të bëhet në përputhje me statutin. Ne, nuk i dimw të gjitha zhvillimet... Vendimet janë nule, e ne po kërkojmë kënd ta njohim...? Nuk e dimw krejt çka ka ndodhur, nuk e dimw gjendjen e degëve, a kanë nënshkruar 16 degë apo jo, kush, sa kanë nënshkruar...Ne, duhet t'i njohim dy vendimet tona...Nëse duam, mund t'i udhëzojmë që të veprojnë në bazë të stautit, dhe t'i drejtohen gjykatës...

Nenad Rikalo: Çka do që ne ndërmarrim, do të kemi dy palë të pakënaqura. Prandaj, duhet të jemi mjaft të vëmendshëm se çfarë vendimi duhet të marrim. Ne, nuk guxojmë të biem në ndonjë situatë të pavolitshme, prandaj duhet ta analizojmë vendimin...Duhet të jemi shumë të qartë në vendimin tonë, të sigurt...

Valdete Daka: Nuk e di në bazë të ligjit se, a kanë ata të drejtë në ndonjë ankesë kundër nesh, sepse ne vetëm po e konstatojmë gjendjen në bazë të dokumentacionit që kemi...Ky, është më shumë një lloj konstatimi, nuk është vendim...Ky është në fund vendim administrativ, dhe ata kanë të drejtë me shkuar me hapë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente, e që është Departamenti Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe atje me realizuar të drejtën e tyre nëse ata, konsiderojnë se ne e shkelë ndonjë të drejtë...

Binak Vishaj: Mendimi im është se Zyra, duhet të japë këtë përgjigje: duhet t'i përmbajë dy elementet e para kur thotë se “Kuvendi është i jashtëligjshëm” dhe, “Vendimet e kryesisë aktuale janë të jashtëligjshme” që ka bërë emërime dhe ka shtuar numrin se ai, mund e ndërron komplet numrin e këshillit drejtues dhe i bënë njerëzit e vet, do të thotë edhe çdo vendim tjetër është i jashtëligjshëm. Pjesa udhëzuese duhet të thotë se, ju duhet t'lypni zgjidhje n'statutin e juve të partisë, dhe në gjykatën përkatëse...Kurse, ZRPP kur e merr listën e azhurnimeve ka me ju thanë atyre se, në përputhje me kuvendin e fundit keni me i pru listat...

Iir Gashi: Është konstatim i të gjithëve se, pas 28.09.2016, çdo vendim, kuvendi dhe secili vendim tjetër, janë nule. E dyta, logjikisht, të gjithë anëtarët, këshilli drejtues, dhe kryesia e vjetër e të dy grupacioneve kanë bazë në status, me thirr kuvend, kuptohet duke i respektuar normat...

Valdete Daka: Ne, mendoj që erdhëm deri te një konstatim që zyra duhet ta formulojë...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan konstatimet e ZRPP-së që do t'i dërgohen Partisë së Drejtësisë, lidhur me ecurinë e Kuvendit të Jashtëzakonshëm, dhe emërimet e anëtarëve në organet drejtuese nga kryetari me, 7 vota për dhe 4 abstenime (Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Ercan Spat dhe Nenad Rikallo).

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për shfuqizimin e pezullimit për katër (4) parti politike

Miradije Mavriqi, drejtoresh e ZRPP-së, tha se me vendim të KQZ-së, janë pezullu 8 parti politikse sepse, nuk ju kanë përmbajtur afatit ligjor për dorëzimin e azhurnimeve vjetore, sipas afatit: 31 janar, 2017.

Në afat shtesë, 4 parti politike, kanë dorëzuar azhurnimet. Kanë mbetur edhe 4 parti, pa i dorëzuar. Zyra, rekomandon heqjen e pezullimit – shfuqizimin e tij.

Valdete Daka: Për shfuqizim, janë këto parti:

1. Aktivna Gragjanska Iniciativa.
2. Kosova Adalet Turk Partisi.
3. Partia e Gjelbërt e Kosovës.
4. Lëvizja për Bashkim.

Betim Gjoshi: Kam pyetje: Denim..., a kemi dënim për këto parti që po i shfuqizojmë?

Valdete Daka: Po...

Miradije Mavriqi: Janë në rekomandim saqrimet...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së për shfuqizimin e pezullimit të këtyre katër partive.

Shqyrimi dhe miratimi i Rekomandimit për shqiptimin e gjobave për tri (3) parti politike

Miradije Mavriqi: Gjobat, shqiptohet varësisht se sa ditë, partitë i kanë vonaur dorëzimet e azhurnimeve nga marrja e vendimeve të KQZ-së. Partia Aktivna Gragjanska Iniciativa, i ka dërguar azhurnimet, po të njejtën ditë që është marrë vendimi për pezullim, do të thotë më 7 shkurt, 2017 dhe kjo, nuk rekomandohet për gjobë. Tri subjektet e tjera, rekomandohen për gjobë, varësisht se sa ditë janë vonaur...

Betim Gjoshi: Gjobat, a vendosen prej datës së skadimit, a prej datës që kemi marrë vendim ?

Miradije Mavriqi: Sipas rregulles, dënimi fillon nga dita e marrjes së vendimit nga KQZ.

Valdete Daka: Kush është për shqiptimin e gjobës për subjektin Kosova Adalet Turk Partisi, Partia e Gjelbërt e Kosovës dhe Lëvizja për Bashkim? Gjoba, është: 300, 320 dhe 600 euro...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për shqiptimin e gjobave për tri (3) parti politike

Betim Gjoshi: Po pyes se, edhe sa ditë i kanë këto tjerat që janë për me u ç'registruar...?

Miradije Mavriqi: Me vendim të KQZ-së, janë 20 ditë.

Valdete Daka: Edhe sa ditë ju kanë mbetuë...?

Miradije Mavriqi: Edhe 3 ditë....!

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Strategjisë të Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale 2017

Adnan Rrustemi: KOZ-i ka shqyrtuar draft – strategjinë për Informim Publik për Zgjedhjet e ardhshme lokale të këtij viti. Ju e keni materialin, dhe mund të them se strategjia përfshinë qëllimin, objektivat, aktivitetet, grupet e fokusuara por, përfshinë edhe disa prej indikacioneve se: si do të dizajnohet mesazhi, dhe se si do të bartet ai tek votuesit, pastaj kanalet e informimit. Ka disa ndryshime, dhe synon t'i ndjekë trendet e teknologjisë, si dhe ato socio kulturorë etj.

Unë, pa e analizuar secilën kategori, them se për secilin aktivitet do të ketë informacion. Kësaj here, ka disa plotësime me disa aktivitete, si me transmetimin e spoteve në portalet aktuale. Pastaj, edhe përdorimi i rrjeteve sociale në mënyrë sa më aktive. Ne, rekomandojmë për miratim...

Valdete Daka: A ka dikush pyetje, sugjerime...? Nëse jo, kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ-it për Draft-Strategjisë të Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale 2017

4. Këshilli për Cështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendeve Komunale në Komunitat: Istog, Obiliq dhe Ferizaj

Sami Hamiti: Dy kërkesat e para, Istogu dhe Obiliqi, janë shqyrtuar në mbledhjen paraprake, dhe kërkesa e Ferizajit është shqyrtuar në mbledhjen e sotshme, dhe është konstatim i këshillimit që, janë përmbushur kushtet që të bëhen këto zëvendësime.

Valdete Daka: Atëherë, kush është për që Elvira Zeqiraj, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Istog, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re, e cila, e zëvendëson anëtarin e deritashme, Teuta Hasanin.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim me 8 vota të anëtarëve të pranishëm në mbledhje

Valdete Daka: Kush është për që Xhelal Krasniqi, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Obiliq, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i cili, e zëvendëson anëtarin e deritashëm, Haki Jasharin.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim me 8 vota të anëtarëve të pranishëm në mbledhje

Valdete Daka: Kush është për që Habib Kamberi, të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga subjekti politik AAK – LDD, i cili, e zëvendëson anëtarin e deritashëm, Izet Rushitin.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim me 8 vota të anëtarëve të pranishëm në mbledhje

Shqyrtimi dhe miratimi i Draft vendimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogoc, të mbajtura me datën 04 dhjetor 2016, si dhe Rundin e Dytë të Zgjedhjeve të mbajtura më 18 dhjetor 2016

Valdete Daka: E kemi rekomandimin për asgjësimin e këtij materiali...! Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan draft-vendimin për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogoc, të mbajtura me datën 04 dhjetor 2016, si dhe Rundin e Dytë të Zgjedhjeve të mbajtura më 18 dhjetor 2016, me 8 vota të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Betim Gjoshi: Më lejoni të them se, ne po i shkatërrojmë databazat hard copy, por për databazat elektronike, se kemi marrë asnjëherë asnjë vendim. Teknologjia po ndryshon, dhe se ne, si për materialin fizik, si për atë elektronik ne duhet marrë vendim. Ne, nuk po them t'i shkatërrojmë, por si t'i ruajmë, ku t'i ruajmë...? Ka edhe të tjera materiale...

Valdete Daka: Faleminderit, po duhet të mendojmë për këto...

5. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Glllogoc.

Illir Gashi: Zgjedhjet lokale të jashtëzakonshme në Drenas, dhe buxheti për këto zgjedhje është mbështetur në buxhetin e njërive kërkuese. Planifikimin dhe raportin e shpenzimeve, e keni përpara. Për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, në total është kërkuar 338 420 euro. Ky buxhet, përfshinë dy raundet.

Valdete Daka: A ka pyetje...?

Betim Gjoshi: Rreth 70% e buxhetit, duket që ka shkuar për stafin...

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për takimin e punës KQZ –SKQZ

Enis Hamili: Në takimet e mëparshme, ne kemi hedhur idenë që të organizohet një takim i përbashkët mes KQZ-së dhe SKQZ-së si një formë adekuate për trajtimin e krijimit të një rregullativë të brendshme, plotësim – ndryshimet, hartimin e një pjese të rregullaves së re që ka të bëjë me statusin tonë si shërbyes civil...

Ne, kemi bërë draftet që kanë kaluar nëpër disa këshilla, dhe propozimi ynë është të organizojmë një punëtori, në mënyrë që ti kemi këto rregullore sa më shpjete...

Propozimi ynë, është në agjendë. Ky është draft, dhe se me propozimet dhe shqyrtimet e juaja, sigurisht do të marrë formën më të mirë...

Illir Gashi: Në kuadër të kësaj, e kemi shqyrtuar këtë draft. Dhe, kemi konstatuar se, ka buxhet të mjaftueshëm...

Valdete Daka: Ftoj edhe OSBE-në dhe IFES-in të na bashkëngjiten...

Binak Vishaj: Është edhe te këshilli i personelit kërkesa, që më herët nuk e futëm në rend dite: kërkesa e Koordinatorit të Terrenit...Ne, kemi vendosur që kjo kërkesë të shkojë në

këtë punëtori...Dhe, unë jam për që kjo punëtori të shkoj sa më shpejtë, sepse jemi në situatë që mund të kemi edhe zgjedhje të parakohshme...

Valdete Daka: Kush është për këtë agjendë...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan agjendën për organizimin e një punëtorie

6. **Të ndryshme**

Enis Halimi: Si njoftim, them se dy aktivitete që këtë vit kemi vendosur me i organizuar me IFES-in, janë: Hartimi i dokumentit që ka të bëjë me vlerësimin e rreziqeve, dhe Plani i Monitorimit të zbatimit të Strategjisë. Për pak ditë, ne do t'i dërgojmë në KOZ de ju, do t'i keni...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare

=====